

Komente mbi:

- 1. Trajtimi i politikës monetare – Eksperienca Greke**
- 2. Çështje të veçanta të politikës monetare – Eksperienca Turke**
- 3. Trajtimi i politikës monetare – Eksperienca Kroate**
- 4. Trajtimi i politikës monetare – Eksperienca e Bosnjë – Herzegovinës**
- 5. Trajtimi i politikës monetare – Eksperienca Shqiptare**

Nga Z. Marian Gjermeni

Drejtor i Departamentit të Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë.

Duke e marrë të mirëqenë se realiteti është vlerësuesi më i drejtë i efektivitetit të politikës monetare të ndjekur nga vendet pjesëmarrëse në këtë konferencë, unë po lë mënjane mendimet e mia për të, duke organizuar komentet e mia si më poshtë:

1. Mësimet e nxjerra nga zbatimi i politikës monetare.
2. Kuadri i mundshëm i politikës monetare në të ardhmen.

Mësimet e nxjerra nga zbatimi i politikës monetare

- a- Qeveria, nëpërmjet programeve ose marrëveshjeve me institucione financiare ndërkombëtare, duhet të shpallë objektivat e saj publikisht. Këto programe duhet të shërbejnë në të ardhmen si referencë për vlerësimin e aktivitetit të saj ekonomik.
- b- Arritja e mirëkuptimit dhe e mbështetjes së publikut me qëllim shmangien e humbjes së besimit.
- c- Në rast të lindjes së nevojës për ndryshime në politikën e ndjekur, këto ndryshime duhet të jenë transparente për publikun dhe për tregjet duke pasur parasysh njëkohësisht domosdoshmërinë e konsistencës me politikat e mëparshme.
- d- Duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e vendeve të rajonit pjesëmarrëse në këtë konferencë, klasifikohen si ekonomi në tranzicion, duhet të jemi të ndërgjegjshëm që ekziston nevoja për reforma strukturore si në sektorin real dhe në atë financiar.

- e- Mbjajta nën kontroll e deficitit buxhetor dhe mos tolerimi i tij sidomos nëpërmjet vendimit për të lehtësuar politikën monetare.
- f- Ndërtimi dhe ruajtja e pavarësisë së bankës qendrore.
- g- Respektimi i rregullave të lojës dhe përmbushja e vazhdueshme e synimeve, do të ndihmonte në krijimin dhe në rritjen e besueshmërisë. Kjo në të njëjtën kohë do të krijonte kushtet për të shmangur ndonjë sulm spekulativ.
- h- Puno për të krijuar një sistem bankar të shëndetshëm nëpërmjet zbatimit me përpikmëri të rregulloreve, të ndjekjes nga afër të zhvillimeve në aktivitetin kreditues, të monitorimit dhe pse jo shmangies së pozicioneve të hapura në bilancin e bankave ose në bilancet e klientëve të tyre.
- i- Ndjekja me kujdes e prurjeve të valutës duke hartuar politika të cilat duhet të trajtojnë jo vetëm hyrjen e valutës, por dhe rastet e ndalimit të këtyre prurjeve apo të daljes së valutës.

Kuadri i mundshëm i politikës monetare në të ardhmen

Duke supozuar se objektivi kryesor i politikës monetare do të mbetet stabiliteti i çmimeve si dhe që ky objektivi nuk do të zgjerohet apo zëvendësohet nga objektiva të tjerë si: nxitja e rritjes së prodhimit, të punësimit dhe të konkurrencës, më lejoni të them fillimisht se cilat mund të jenë dy strategjitë kryesore të adoptuara nga banka qendrore:

1. Politika indirekte e bazuar në objektivat e ndërmjetëm si: rritja e agregatëve monetarë, norma e interesit apo kursi i këmbimit. Këtu presupozohet se ka një lidhje të parashikueshme ndërmjet objektivit të ndërmjetëm dhe inflacionit të ardhshëm duke iu referuar teorisë sasiore të parasë.
2. Politika direkte e bazuar mbi objektivin final të inflacionit. Zakonisht caktohet një objektivi për ecurinë e inflacionit në të ardhmen, me qëllim lejimin e një kohe vonese midis ndryshimeve të politikës monetare dhe ndikimit të tyre në normën e inflacionit. Në këtë rast politika ndryshon duke u bazuar në variablat e ndërmjetëm të kërkesës dhe ofertës në ekonomi. Në këtë rast ne mund të kemi tre skenarë:
 - “*Strict Constuctionist*” - norma e interesit duhet t’i përgjigjet kursit të këmbimit vetëm kur ndikon inflacionin aktual ose atë të parashikuar (përndryshe do të krijojë konfuzion në publik për sa i përket objektivit final).
 - “*Flexible inflation target*” – kursi i këmbimit mund të jetë një objektivi logjik (i politikës monetare) përkrah inflacionit (në këtë rast ndiqet politika monetare në funksion të kursit të këmbimit vetëm pasi inflacioni mbetet në kufijtë e objektivit).
 - “*Singaporian View*” – ndjeshmëria e inflacionit ndaj çmimeve të importuara (*pass through*) është mjaftueshëm lart dhe stabilizimi i inflacionit kërkon administrimin të kujdesshëm të kursit të këmbimit.

Pasi bëmë një përshkrim të shkurtër të politikave monetare si dhe duke iu kujtuar kuadrin monetar të ndjekur nga vendet pjesëmarrëse: Greqia – *pa politikë monetare*, Turqia *para krize ka ndjekur politikë për zhvlerësimin e kontrolluar të kursit të këmbimit ndërsa tani ka objektiv të deklaruar agregatët monetar dhe si objektiv të nënkuptuar ka inflacionin*, Kroacia *ka deklaruar regjim monetarë ndërsa si objektiv të nënkuptuar ka kursin e këmbimit*, Bosnjë-Herzegovina *ka si politikë “currency board”*, Shqipëria *ka si objektiv të nënkuptuar inflacionin e synuar ndërsa objektiv të shpallur regjimin monetarë*, unë mund të them diçka rreth kuadrit të mundshëm të politikës monetare në të ardhmen për këto vende:

Greqia do mbetet siç është aktualisht.

Turqia modelin e “*Strict Constuctionist*”.

Kroacia modelin “*Singaporian View*”.

Bosnjë - Herzegovina modelin “*Singaporian View*”.

Shqipëria modelin e “Flexible inflation target”.